

# Gjyqtari i Apelit të Tiranës Ridvan Hado para vettingut

18 Qershor 2020 LAJME

---

Po sot një tjetër gjyqtar i Apelit të Tiranës doli para vettingut. Ridvan Hado u paraqit para komisionereve vetëm, pa avokatë mbrojtës për t'u përballur me rezultatet e hetimeve të kryera ndaj tij. Sipas Inspektoriatit të pasurive Hado nuk ka kryer deklaram të rreme të pasurive dhe rezulton pronar ose në bashkëpronësi për disa pasuri që janë të justifikuara.

Hado, sipas hetimit administrativ të pasurisë financiare rezulton të ketë likuiditet kesh më shumë se vlera e lejuar dhe nuk dihet sesi do të ndikojë kjo gjë në vlerësimin përfundimtar të tij.

Përballë Ridvan Hados, përveç trupës gjyquese ishte edhe Theo Jakobs, prokurori belg që shpesh ka vënë në vështiresi me pyetjet e tij prokurorët dhe gjyqtarët.

Ridvan Hado, gjyqtar i Gjykatës së Apelit Tiranë ishte një nga 5 gjyqtarët e Kolegjit Zgjedhor që vitin e shkuar rrëzoi kërkesën e Partisë së Idajet Beqirit për të mos qënë pjesë e zgjedhjeve të 30 qershorit, duke rrëzuar edhe dekretin e Ilir Metës që kërkoi anulimin e zgjedhjeve lokale të një viti më parë.